

**RAPORT MONITORIMI
I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT
TË HEKURUDHËS SHQIPTARE
PËR VITIN 2025
DHE 6 MUJORI I 2026**

12 Gusht 2026

PASQYRA E PROGRAMIT

I- PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	3
1. Profili i Institucionit Hekurudha Shqiptare.....	5
2. Niveli i Integritetit në Institucionin HSH.....	7
II- Masat dhe aktivitetet për zbatim 2025 – 2026 dhe niveli i realizimit për çdo objektiv..	12
3. Vlerësimi i riskut kundër korrupsionit.....	14
4. Planet e riskut me masat antikorupsion.....	16
III- Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të raportuara.....	21
5. Të dhënat dhe ruajtja e tyre.....	25
6. Raportimi dhe monitorimi.....	25
IV- Konkluzione dhe Rekomandime.....	26
7. Konkluzione	27
8. Rekomandime.....	28
V-SHTOJCAT.....	29

I- PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky Raport i hartuar për monitorimin e Planit të Integritetit të Shoqërisë Hekurudha Shqiptare, ndjek modelin të monitorimit, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përmes faqes zyrtare. Për HSH-në, bashkëpunimi efektiv përfshiu nivelet drejtues e menaxherial mbi kontrollin e masave. Për monitorimin e planit të Integritetit të Hekurudha shqiptare (HSH), ka bashkëpunuar me organet e mirëqeverisjes, në nivel qendror, lokal dhe të pavarur, sipas ligjit 90/2012 për administratën shtetërore, të ndryshuar përmes Ligjit nr. 63/2026, datë 2.7.2026 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” e në këto aspekte, për HSH-në, mund të përmendim Programet të Reformave dhe Agjendën Kombëtare të Reformave.

Hekurudha shqiptare zbaton Strategjinë Antikorrupsion, sipas Vendimit Nr. 859, Datë 26.12.2024 Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës, botuar në Fletoren zyrtare Nr. 225, datë. 30/12/2024; Ligjit Nr. 142/2016 Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë Nr. 265, Datë. 31/12/2016, si dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, botuar në Fletore Zyrtare Nr. 31, datë 24/02/2023. Hekurudha Shqiptare bashkëvepron me organet përgjegjës dhe institucionet shtetërore, në kryerjen e detyrave, me integritet dhe Etikë, sipas Kodit të Etikës të shoqërisë, për të cilat kemi konkluduar marrëveshje për bashkëpunim dhe memorandum të mirëkuptimit, duke vepruar me koherencë dhe korrektësi, sipas planit të veprimit dhe koordinimit ndërsektorial të Strategjisë kundër Korrupsionit.

Hekurudha Shqiptare bashkëpunon, në detyra të përgjegjësisë institucionale dhe shtetërore, me: Zyrën e KM-së, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencinë e Prokurimit Publik, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Institutin Kombëtar të Statistikave, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministër Shteti dhe Kryenegociator, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministër Shteti për Pushtetin Vendor, Policinë e Shtetit, Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Inspektoriatin shtetëror Teknik dhe industrial, me ARH-në, me Autoritetin e Sigurisë hekurudhore, Institutin e Transportit, si dhe organet e tjerë.

Për Hekurudha Shqiptare, (HSH Sha), në monitorimin për 2025-2026, deklarohen masat përkatëse.

- I. Ngritja dhe funksionimi i Autoritetit përgjegjës, për parandalimin e konfliktit të interesit, me Autorizimin nga Administratori i Shoqërisë, më datë 17 Dhjetor 2025, me:
 - (1) Drejtuesin e shërbimeve të brendshme mbështetëse;
 - (2) Përgjegjësën e sektorit juridik; DSHBM, HSH; dhe
 - (3) Përgjegjësën e sektorit të burimeve njerëzore, për Hekurudha shqiptare (HSH).
- I. Përditësimi i “Deklaratës së moskonfliktit të interesit” të Administratorit të Shoqërisë;
- II. Dorëzimi i Deklaratës së cilësisë së efektivitetit të funksionit të kontrollit të brendshëm;
- III. Dorëzimi i Deklaratës së riskut fiskal, me masat, për vlerësimin, dhe kontrollin të KB;
- IV. Përditësimi i regjistrave të riskut dhe planeve të veprimtë të menaxhimit dhe kontrollit;

Raportimi i planit të Integritetit Hsh synon përditësimin me hapat sistematikë të veprimtarisë, me:

- Përmirësimin e standarteve të aksesit të informacionit publik, duke synuar rritjen e transparencës përmes programit transparent, si dhe Planit të Integritetit, sipas monitorimit;
- Përditësimin e bazës ligjore përmes akteve ligjore dhe nënligjore, duke vënë theksin tek integriteti dhe etika institucionale e veprimeve, masave, detyrimeve dhe drejtave të HSH;
- Forcimin e mekanizmave institucional të pjesëmarrjes së publikut, duke krijuar aksesueshmëri për rolin, të HSH, në vendimmarrjen institucionale, dëgjuesat me publikun;
- Zhvillimin e mekanizmave planifikues, programimit statistikor të ndërmarrjes (Shoqërisë), monitorimit dhe të kontrollit të brendshëm, për menaxhim me efikasitet të fondeve publike.

Monitorimi i Planit të Integritetit për HSH, parashikon masa të karakterit operacional, rregullator, kontraktual, ligjor, veprimet prej të cilave, janë parashikuar për t’u përmbushur, në një seri të aktiviteteve, për fushat e përgjegjësisë së HSH, të ndarë në objektiva tematik, përkatësisht, sipas:

- Përmirësimi të etikës dhe mekanizmave të integritetit në HSH, përmes ndërhyrjeve ligjore;
- Përmirësimi të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, ku përfshihen, prokurimet, investimet publike, komunikimi dhe zgjidhja e ankesave, TIK;
- Rritjes së transparencës, për shërbimet publike me hekurudhë dhe pjesëmarrjes së publikut;
- Përmirësimi të sistemit të menaxhimit financiar të monitorimit të kontrollit të brendshëm;
- Përmirësimi të drejtimit dhe menaxhimit të kontrollit të brendshëm në zbatim, të politikave, për të promovuar Integritetin, parandaluar korrupsionin, në fushat e përgjegjësisë së HSH.

Raporti përmbledh masat e ndërmarra dhe nivelet e realizimit të tyre, nga Hekurudha shqiptare e cila ka monitoruar të 8 (tetë) njësitë shpenzuese, sipas legjislacionit në fuqi, me të dhënat, për:

I. Titullarin e Institucionit Hekurudha Shqiptare- Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë;

1. Administratori i shoqërisë HSH, (I cili nuk është anëtar i Këshillit mbikëqyrës);

1.1. Asistenca Administratorit të shoqërisë; dhe 1.2 Sektori i Auditit Brëndshëm (SAB/NJAB/AB);

2. Drejtoria Ekonomike dhe Administrimit të Riskut (DEAR); 3. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme Mbështetës (DSHBM); 4. Drejtoria e Zbatimit dhe Menaxhimit të Projekteve (NJZMP); 5. Njësia e biznesit të mallit (NJBM); 6. Njësia e biznesit udhëtar (NJBU); 7. Njësia e shërbimit të mjeteve lëvizës (NJSHML); dhe 8. Njësia e menaxhimit të infrastrukturës (NJBMIH).

1. PROFILI I INSTITUCIONIT HEKURUDHA SHQIPTARE

Me Raportin aktual të monitorimit të Planit të Integritetit, për shoqërinë aksionare HSH SH. A, themeluar në 17/11/2000, HSH-ja, merr përsipër të raportojë, në zbatim të bazës ligjore në fuqi, për sektorin hekurudhor dhe Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike, për moskonfliktin e interesit për personat e emëruar dhe që ushtrojnë poste publike, si dhe dispozitave rregullore ekzistuese, sipas ndryshimeve të Rregullores së organizimit dhe funksionimit të shoqërisë, të ndryshuar, ku Hekurudha shqiptare vepron me organet drejtuese:

- (i) Këshillin Mbikëqyrës, (i kryesuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë); dhe
- (ii) Administratori i Shoqërisë, (i cili nuk është anëtar i këshillit mbikëqyrës), sipas statutit.

Në përcaktimin të integritetit, me të cilën vepron në emër të shoqërisë HSH Sha, sipas ligjit 90/2012 mbi administratën shtetërore, të ndryshuar në vitin 2025 dhe Kodit të Etikës Hekurudha shqiptare, sipas vendimit të Administratorit nr. 11, datë 16/7/2018, i cili përfshin moskonfliktin e interesit, në nenin 4.2., që rregullon marrëdhëniet, ku punonjësit e HSH-së, nuk duhet të marrin pjesë në aktivitete, të cilat konsiderohen, si konflikt interesi, në HSH, zbatohet rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit, Nr.1355/1 prot., më 11.12.2019 Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave, në ushtrimin e Funksioneve Publike në Hekurudha Shqiptare.

Për monitorimin e zbatimit të Kodit të Etikës dhe Integritetit, HSH SHA, veprohet sipas:

1. Rregullores e Statutit të shoqërisë, me ndryshimet, i cili përbën bazën ligjore për Kodin e Etikës;
2. Kodit të Etikës me parimet për Integritetin, për punonjësit e administratës Hekurudha Shqiptare;
3. Bazës ligjore për Kodin e Etikës, si Kodi i Punës dhe Ligjit për shoqëritë tregëtare, të ndryshuar;
4. Statutit të shoqërisë dhe Kodit për etikën e integritetit, link: <https://hekurudha.al/kodi-i-etikes/>


Masat rregullore janë monitoruar nga Rregullorja për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike në Hekurudhen Shqiptare, që përfshin Rregullat të Përgjithshme: Neni 1, Baza ligjore. Rregullorja hartohet dhe miratohet në bazë të nenit 46, paragrafi 1 i ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, bazohet në ligjin e mësipërm, si dhe në ligjin nr. 9049 datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, si dhe në zbatim të “Rregullores së Organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë”, të ndryshuar; Neni 2, Qëllimi; Neni 3 Objekti. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësi dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave; Neni 4, Shpjegim i termave. Neni 5, Çastet e vendimmarrjes. Neni 6, Kompetencat thelbësore dhe Neni 7, Interesat private. Ngritja dhe Funksionimi i Strukturave Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, bëhen me rregullat, që zbatohen, raportohen në monitorim për integritet dhe llogaridhënie.

Në këtë raport monitorohet mbi integritetin, me programin e transparencës në përputhje me germën b), të pikës 1 të nenit 2 dhe nenit 7, të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i cili është përditësuar gjatë vitit. Ky program transparent, i cili përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë, në kuadër të Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, vlerësohet si një mënyrë konkrete, përmes së cilës Shoqëria Tregtare Hekurudha Shqiptare, ndërton vijimisht dhe rrit transparencën në punën institucionale, nën garancinë e ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Hekurudha Shqiptare e përditëson mbi baza ditore dhe periodike, programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Sipas Ligjit, është respektuar afati për rishikimin e programit të transparencës, që mund të ndryshojë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet.

Informacioni i bërë publik në këtë program (HSH), ka bërë të mundur, transparencën e veprimtarisë së punës së HSH-së, nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të shpallur, në faqen zyrtare www.hekurudha.al, dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës për HSH, pasqyrohet në rubrika, përmbajtje, afat për bërjen publike, mënyrën e bërjes publike dhe strukturën përkatëse, e cila prodhoi ose administroi dokumentet. Në përmbajtje të programit të transparencës për HSH, evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron modulet, ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet për HSH. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm si link i skemës.

Përditësuar 31/03/2026



(Burimi: Hekurudha Shqiptare faqja zyrtare: www.hekurudha.al ; <https://hekurudha.al/programi-i-transparences-3/>)

2. NIVELI I INTEGRITETIT NË INSTITUCIONIN HSH

Faqja zyrtare e institucionit HSH, ka shpallur përditësime të bazës ligjore, vendimeve, përkatësisht, sipas komunikimit në formë të rregullt, sipas miratimit "Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve në HSH", (2019) dhe link: <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>

HSH-ja, ka përditësuar mbi masat, nga planet e veprimit me organizmat të nivelit Evropian dhe ndërkombëtar, si plani *Benchmarks*, të Komisionit Evropian dhe sondazhet nga Komiteti Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për Evropën, sondazhet nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare, dhe raportet në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, për sondazhet me Organizatën Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim, mbi vlerësimin e performancës.

INFORMACIONI MBI PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN, përmbledh një seri rregullash:

Vendim Nr. 275, Datë 9.5.2025 Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Mashtrimit për mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian, 2025–2030, dhe Planit të saj të Veprimit.

Ligjin nr. 18/2025, datë 13.3.2025 Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për “Lehtësinë e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”.

Ligjin nr. 19/2025, datë 13.3.2025 Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 2.5.2025 Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes së facilitetit, ratifikuar me ligjin nr. 19/2025.

Ligjin nr. 8/2018 datë 26.2.2018 Për ratifikimin e traktatit që themelon Komunitetin e Transportit.

Ligjin nr. 8/2024, datë 8.2.2024 Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, për programin (Interreg VI-A), Itali–Shqipëri–Mali i Zi (Adriatiku Jugor), 2021–2027.

Raport progresin per Shqiperine, Bruksel, 4.11.2025 SWD(2025) 750 final DOKUMENTI I PUNËS I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti i Shqipërisë 2025 që shoqëron dokumentin Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Komunikimi i vitit 2025 mbi politikën e zgjerimit të BE-së {COM(2025) 690 final} – {SWD(2025) 751 final} – {SWD(2025) 752 final} {SWD(2025) 753 final} – {SWD(2025) 754 final} – {SWD(2025) 755 final} {SWD(2025) 756 final} – {SWD(2025) 757 final} – {SWD(2025) 758 final} {SWD(2025) 759 final}

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 159, datë 20.10.2025 Për miratimin e rregullores “Mbi specifikimet e përbashkëta për regjistrin e infrastrukturës hekurudhore”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 138, datë 30.9.2025 Për miratimin e rregullores “Për kushtet teknike të ndërveprimit në lidhje me ‘Sigurinë në tunelet hekurudhore’ të sistemit hekurudhor shqiptar”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 153, datë 10.10.2025 Për miratimin e rregullores “Mbi specifikimet për regjistrin e mjeteve hekurudhore”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 137, datë 30.9.2025 Për miratimin e rregullores “Për kushtet teknike për ndërveprimin në lidhje me aksesueshmërinë e sistemit hekurudhor për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të reduktuar, identifikimin e barrierave, monitorimin dhe raportimin e progresit të aksesueshmërisë”

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 300, datë 27.11.2024 Për miratimin e rregullores “Për kriteret e kërkuesve për kapacitete të infrastrukturës hekurudhore”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 301, datë 27.11.2024 Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kuadër për ndarjen e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 302, datë 27.11.2024 Për miratimin e rregullores “Kushtet teknike për ndërveprueshmërinë në lidhje me nënsistemin ‘Aplikacione telematike për shërbimet e udhëtarëve’ të sistemit hekurudhor”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 286, datë 19.11.2024 Për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e procedurës dhe kriterëve për zbatimin e testit të ekuilibrit ekonomik në transportin hekurudhor të udhëtarëve”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 323, datë 30.12.2024 Për miratimin e “Dokumentit të politikave për zhvillimin e sistemeve inteligjente të transportit, ITS-së, në transportin hekurudhor dhe detar”

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 164, datë 21.10.2025 Për miratimin e rregullores “Mbi aspekte të caktuara të kushteve të punës së punonjësve të lëvizshëm të angazhuar në shërbime ndërvepruese ndërkufitare në sektorin hekurudhor”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 285, datë 19.11.2024 Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) për mbikëqyrjen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore pas lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë dhe për kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 167, datë 13.12.2023 Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e disa aspekteve të procedurës së licencimit të sipërmarrjeve hekurudhore”.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 169, datë 13.12.2023 Për miratimin e rregullores “Për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore”.

Vendimin Nr. 88, Datë 22.2.2023 Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 170, datë 13.12.2023 Për miratimin e rregullores “Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që zbatohet nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, pas marrjes së certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.789, datë 24.12.2025 Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2026, përafruar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit (EU) 2025/1926, të datës 31.10.2025, e cila ndryshon aneksin I, të rregullores (EEC) nr.2658/87, “Mbi Nomenklaturën Tarifore dhe Statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore”.

Kërkesën e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 756/10, datë 2.10.2025 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës– Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”, të ndryshuar.

Udhëzimin e ministrit të Financave nr. 22, datë 15.9.2025 Për përcaktimin e metodologjisë së përgatitjes së studimit të plotë të fizibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fizibilitetit, në përputhje të plotë të udhëzimeve të KE-së mbi kryerjen e analizës së qëndrueshmërisë financiare.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 26.11.2025 Për një ndryshim në vendimin nr. 91, datë 12.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2026–2028”, të ndryshuar, Për ndryshimet e reflektuara, vlerat janë konvertuar me kursin e këmbimit të muajit nëntor 2025_inforeuro, dhe shenimet (per projektet me status te maturuar, per transportin hekurudhor), ku: * Projekti ka përfituar investim WBIF. ** Asistencë teknike WBIF.

VKM 144, datë 6.3.2025 Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe planit të veprimit 2025–2030, në përputhje me Kuadrin e ri Strategjik të BE-së për SSHP-në 2021–2027; – Direktivën e Këshillit të BE-së 89/391/EEC, të 12 qershorit 1989, për prezantimin e masave për të nxitur përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve në punë.

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 250, datë 25.10.2024 Për miratimin e rregullores “Për modalitetet e llogaritjes së kostos që shkaktohet drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të trenave dhe aplikimit të tarifimit për koston e efekteve të zhurmës”.

Ligjin nr. 1/2025, datë 30.1.2025 Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, me ligjin nr. 29/2017.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 26.12.2024 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, (në përputhje me S3 të Bashkimit Evropian).

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës Energjisë nr. 181, datë 19.12.2025 Për miratimin e rregullores “Për kushtet teknike për ndërveprimin në lidhje me nënsistemin ‘energji’ të sistemit hekurudhor dhe dispozitat për sistemin e matjes së energjisë dhe sistemin e mbledhjes së të dhënave”.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 28.1.2026 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës–Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”, të ndryshuar, (sipas metodologjisë së ndryshuar me kërkesat e performancës me Bankën Evropiane për rindërtim dhe zhvillim dhe Strukturën e Investimeve të Ballkanit perëndimor).

Ligjin nr. 96/2025, datë 18.12.2025 Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, përafër plotësisht me direktivën nr.2019/1937/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 tetor 2019, “Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit.” Numri CELEX 32019L1937, Fletore Zyrtare Bashkimit Evropian, OJ L, 305, datë 26.11.2019, f. 17–56.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 304, datë 22.5.2024 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj 2024–2027, në koherencë të plotë me objektivat ndërkombëtarë për zhvillim të qëndrueshëm, me kuadrin ligjor të BE-së në këtë fushë, si edhe me angazhimet e ndërmarra nga pala shqiptare.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 21.1.2026 Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2026–2028, sipas sistemit Evropian të llogarive (ESA) dhe MSA, për raportimin ndaj BE, përfshihen NSH (ndërmarrjet shtetërore), me grante dhe hua të BE (sovrane).

Vendimet të Këshillit të Ministrave: VKM Nr, 239, Datë 18.5.2022; VKM Nr, 657, Datë 31.10.2018. Urdhëra dhe Udhëzime: Urdhër Nr. 170 datë 13.12.2023; Urdhër Nr. 167 datë 12.12.2023; Urdhër Nr. 123 datë 10.10.2023; Urdhër Nr. 24 datë 13.12.2022; Urdhër Nr. 52 datë 17.03.2022 dhe Udhëzim 15/2023 “Për shërbimet publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve”.

Niveli i integritetit po përmirësohet me Trajnimet, të cilat janë zhvilluar gjatë gjithë vitit raportues (2025), dhe gjysmës së parë të vitit 2026, ku Drejtoria e shërbimeve të brendshme mbështetës, DSHBM-ja, e cila ka në varësi sektorin e teknologjisë dhe infomimit, i raporton, sipas realizimit. Për trajnime të fushës për zbatimin me rregullat e mospërfshirjes në zgjedhje elektorale, sipas legjislacionit nga Komisioni qëndror; dhe të tjera trajnime, përfshirë edhe arshivimin e dokumentave, të cilat janë kryer gjatë vitit 2025 dhe gjysmës së parë të 2026, si dhe standartet e auditimit të informacionit ISO 270001; me monitorimin e sistemit të Administrimit të aseteve (ISO 55000-1, 2); trajnime të projektit në rolin mbi barazinë gjinore dhe të procedurave të prokurimit të hapur për projektet, ku kanë marrë pjesë të gjithë përgjegjësit të sektorëve të financës, sektorit të prokurimit publik, burimeve njerëzore, si dhe zbatimit dhe menaxhimit të projekteve (2025-2026).

Hekurudha ka përditësuar Raportin e Cilësisë së shërbimit për udhëtar (2025), Raportin e Sigurisë për veprimtarinë për mallrat, udhëtarët hekurudhorë, si dhe menaxhimin e Infrastrukturës, (2025). Në bazë të Kodit Etik të HSH sh.a., i cili është pjesë integrale e rregullores së punës në HSH sh.a., punonjësit e HSH zbatojnë ligjet dhe rregulloret, në fuqi, duke përfshirë shtesat dhe ndryshimet.

Si një paketë përmbledhëse tërësore, keto rregulla udhëheqin punën e përditshme, të personelit të HSH-së. Njohja e detyrimeve dhe të drejtave, e parimeve dhe vlerave, sipas Kodit të Etikës së HSH, kërkon nga punonjësit që punojnë pranë shoqërisë HSH sh. a, që të zbatojnë standartet më të larta të sjelljes etike, në përputhje me vlerat e integritetit, të paanshmërisë dhe të maturisë. Punonjësit e shoqërisë HSH sh. a, inkurajohen të punojnë me profesionalizëm, për të arritur rezultate sa më të larta e të qëndrueshme. Ata veprojnë me integritet, gjatë gjithë veprimtarisë së tyre zyrtare dhe shmangin çfarëdolloj sjelljeje, që mund të paraqesin ndryshe punonjësit ose HSH. Me karakterin profesional dhe vlerës, që i jep diversitetit, HSH orienton stafin e vet, të veprojnë me tolerancë, me ndjeshmëri, me respekt dhe me paanësi, kundrejt kulturës, përfshirë kulturën e sigurisë hekurudhore, dhe profesionit të personave të tjerë, që nuk i kanë ato të njëjta me të tjerët.

Për stafin e HSH, integriteti është mirëkuptuar si sinonim i ndershmërisë, korrektesës, drejtësisë, besnikërisë kundrejt punës dhe institucionit. HSH ka reaguar, ndaj çdo sjelljeje abuzive, e cila mund të konsiderohet joetike. Punonjësit e HSH i kanë përmbushur detyrat e tyre me kompetencë, paanshmëri, duke zbatuar standarte të larta profesionale në kryerjen e punës së tyre dhe duke mbajtur përgjegjësi për to. Sektori i burimeve njerëzore të drejtorisë së shërbimeve të brendshme mbështetës në bashkëpunim me sektorin juridik dhe strukturat të burimeve njerëzore të njësive të biznesit dhe shërbimeve hekurudhore, kryen përditësimin përmbi to. Njësitë e zbatimit të menaxhimit, të biznesit dhe shërbimeve hekurudhore, kanë ngritur grupet e veta të menaxhimit të riskut, të cilat kryejnë takime periodike të shpeshta, për konsultimin të të gjitha rregulloreve, udhëzimeve, urdhërave, për funksionimin e grupeve të punës dhe informimit për to.

Trajnime të vlefshme janë kryer nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ku merr pjesë HSH-ja, me Ministrinë MIE, duke qenë të certifikuara nga ASPA, sipas procesit të punës, në çështjet, lidhur me integrimin Evropian të sektorit transportit strategjik hekurudhor në 2025-2026: "Kurs online me temë: "Procesi i negociatave të pranimit në BE dhe monitorimi" tre seanca - të pajisura me certifikatë pjesëmarrjeje për pjesëmarrësit e HSH, anëtarët të grupit të Integritetit BE. "Kurs online me temë: Mekanizmi i koordinimit dhe qeverisjes ndër-institucionale për integrimin evropian" katër seanca - të pajisura me certifikatë pjesëmarrjeje, për anëtarët e GNPIE, (HSH). "Kurs online me temë: Identifikimi i grupeve të interesit për pjesë të caktuara të procesit të negociatave" tre seksione (të plotësuara me certifikatë pjesëmarrjeje), për anëtarët GNPIE, (HSH). "Kurs online me modul të trajnimit: "Vlerësimi dhe përgatitja e pikave të hapjes", 18 orë online (3 ditë), të plotësuara me certifikatë pjesëmarrjeje, për anëtarët e grupit të integritetit GNPIE, HSH.

Në grupkapitullin 4, të agjendës së gjelbër, për ndërlidhshmërinë e rrjeteve dhe për një transport të qëndrueshëm, marrim pjesë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mjedisit/AKM, Ministrinë e Mbrojtjes dhe AKMC, si dhe Agjencinë SASPAC, për marrëveshjet me BE. Hekurudha ka kontribuar me informacion adekuat, në lidhje me kontributin për Shqipërinë me Zyrën e KM, si dhe Ministër shteti dhe Kryenegociator, me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Sigurisë Hekurudhore dhe Autoritetin Rregullator Hekurudhor dhe të tjerë.

Takimi me Nën-Komitetin për Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal, u mbajt në datë 3.06.2026 dhe Hekurudha shqiptare mori pjesë në formë hibride/online, mbi zhvillimet e rekomandimet e vlefshme nga Komisioni Evropian, dhënë me anë të DG MOVE dhe DG ENEST.

II- Masat e aktivitetet për zbatim në 2025-2026 dhe niveli i realizimit për çdo objektiv

Në planin e veprimit të miratuar për zbatimin e planit të integritetit për 2025 me **288 gjithsej, u përmblodhën raportimet perkates (277 masa dhe 11 aktivitete), të përmbushur,** për vitin raportues dhe të ndarë sipas objektivave, si më poshtë:

Objektivi 1. Përmirësimi i Etikës dhe Mekanizmave të Integritetit në HSH

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara	Plotësisht të realizuara	Pjesërisht të realizuara	Të parealizuara
Përmirësimi i Etikës dhe Mekanizmave të Integritetit në HSH	Plani i masave	102	102	0	0

Objektivi 2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara	Plotësisht të realizuara	Pjesërisht të realizuara	Të parealizuara
Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse	Plani i masave	24	24	0	0

Objektivi 3. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara	Plotësisht të realizuara	Pjesërisht të realizuara	Të parealizuara
Rritja e transparencës, pjesëmarrjes	Plani i masave	25	25	0	0

Objektivi 4. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit, monitorimit, kontrollit të brendshëm

Objektivi 4	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara	Plotësisht të realizuara	Pjesërisht të realizuara	Të parealizuara
Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe monitorimit kontrollit të brendshëm	Plani i masave	47	47	0	0

Objektivi 5. Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në fushat e përgjegjësisë

Objektivi 5	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara	Plotësisht të realizuara	Pjesërisht të realizuara	Të parealizuara
Përmirësimi i drejtimeve ndërhyrjeve të politikave, promovuar integritetin e parandaluar korrupsionin në fushat e përgjegjësisë	Plani i masave	90	90	0	0

3. VLERËSIMI I RISKUT KUNDËR KORRUPSIONIT

Vlerësimi i riskut bazohet në deklaratën e misionit dhe objektin e veprimtarisë së HSH, të publikuar në portalin zyrtar të HSH. Procesi është mbështetur nga dokumentacioni shoqërues (Regjistri i Riskut, pyetësorë vetëvlerësimi, plan masash, matrica risku, gjurmë auditit, program transparence), të raportuar në takimin vjetor të menaxherëve të njësive shpenzuese (13.02.2026).

Sipas portalit të vet zyrtar të shoqërisë, HSH ka publikuar mbi "Misioni – Ç'ka Bëjmë", ku përmbledhet misioni, nga Objekti i veprimtarisë së shoqërisë, që është transporti i udhëtarëve dhe mallrave, ngarkim/ shkarkim dhe shërbime të tjera hekurudhore në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nëpërmjet stacioneve kufitare edhe për në vendet e tjera". Në funksion të vizionit për një transport hekurudhor modern dhe me standard, HSH përpiqet që të sigurojë shërbim publik: (i) Të Besueshëm; (ii) Të Rehatshëm; (iii) Të Përballueshëm; (iv) Të Sigurt; dhe (v) Të Shpejtë. Shoqëria Hekurudha shqiptare, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të reja, si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera jashtë vendit, sipas: <https://hekurudha.al/misioni/>.

Për këtë qëllim, është miratuar deklarata e misionit HSH, me kërkesat e ligjit, sipas regjistrit të riskut dhe deklaratës së cilësisë. Shkresa zyrtare dërguar MF dhe MIE në periudhat në Janar dhe Shkurt 2026, me të dhenat të të gjitha njësive shpenzuese të HSH-së, mbi kërkesën për raportim lidhur me udhëzimin MF, me paketë të dokumentacionit shoqërues, si në: Urdhërin për GMS nr. 5, datë 19.01.2026, urdhërin për GMR nr. 6, datë 19.01.2026, Deklaratën e cilësisë datë 19/01/2026, Regjistrin e riskut të HSH, Pyetësorin e vetëvlerësimit të HSH, Planin e masave për menaxhimin e riskut, matricën e riskut dhe gjurmët e auditit, programin e transparences dhe shtojcat. Të gjithë menaxheret drejtues të njësive shpenzuese të HSH, raportuan më 13.02.2026 dhe miratuan minutat. Raportet e integritetit dhe zbatimet janë përditësuar, përmes takimeve të konsultimit administrativ. Takimi i grupit të menaxhimit të riskut në 13.02.2026 per GMR, sipas urdhërit, me përfaqësuesit menaxherial dhe kontrollit KB, si anëtar të GMR HSH 2026, raportuan zbatimin e masave të planit, përmes 13 'Objektivave Specifike' dhe monitorimit të masave antikorruption, të cilat rrjedhin prej:

Objektivit Specifik 1: Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur;

Objektivit Specifik 2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas;

Objektivit Specifik 3: Kontroll i brendshëm efektiv;

Objektivit Specifik 4: Qëndrueshmëria e Strukturës së shoqërisë tregëtare me kapital shtetëror;

Objektivit Specifik 5: Transparenca financiare hekurudhore/ administrimit të infrastrukturës;

Objektivit Specifik 6: Përditësimi i programeve të shoqërisë dhe politikat e industrisë hekurudhore;

Objektivit Specifik 7: Statistika monetare, financiare, tregtare e bilancit të pagesave për HSH-në;

Objektivit Specifik 8: Pjesëmarrja në politikat rajonale të instrumenteve strukturore (state-of-play);

Objektivit Specifik 9: Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike;

Objektivit Specifik 10: Transparencë e Financave Publike;

Objektivit Specifik 11: Zbatim efikas i buxhetit;

Objektivit Specifik 12: Bashkëpunimi i ngushtë mes njësisish, të menaxhimit financiar dhe ekonomik, prokurimit, administrimit, menaxhimit, kontrollit, zbatimit të projekteve të akorduara;

Objektivit Specifik 13: Mbledhja e të ardhurave.

Për shoqërinë Hekurudha shqiptare Sha (NIPT: J61811547D), bazuar në nenin 135 e vijues të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si edhe të statutit të shoqërisë HSH sh. a, ku Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë HSH sh. a, me të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme që ushtrohen nga aksioneri i vetëm i shoqërisë, (shteti shqiptar), dhe ku Aksioneri i vetëm përfaqësohet nga Ministria përgjegjëse; Shoqëria vepron ligjërisht, sipas statutit të shoqërisë HSH Sha. Titullari (Këshilli Mbikëqyrës) dhe Administratori i Shoqërisë, kanë kryer me përpikmëri monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëshuara mbi mirë-administrimin, menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm, me masat kundër korrupsionit, përmes udhëzimit administrativ dhe regjistrimit të riskut, i cili rishikohet 3 (tri) here, brenda vitit, çdo 4 Mujor dhe këto veprime, të cilat mbrohen nga parimi i integritetit, përfshihen në bazat ligjore të çdo dokumenti shkresor, lëshuar nga Hekurudha. Po priten raportet e rinj, me caktimin e eksperteve të auditimit, të komitetit të auditimit të ndarjes së HSH. Bordi drejtues (këshilli mbikëqyrës) i shoqërisë, ka në përbërje një kryetar (MIE) dhe anëtarët nga background-e të ndryshme, që plotësojnë më së miri, me fushat e ekspertizes e kompetencat sipas statusit, për të kryer rishikimin kritik të sistemit e të strukturave të antikorrupsionit të sektorit strategjik hekurudhor, mbi monitorimin e të gjithë sistemeve, me masat për menaxhimin efektiv.

Urdhëri i MIE-së, nr. 141, datë 02.10.2025 Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e planit të veprimit për përafrimin e legjislacionit në kuadër të piketave përmblylësë, të kapitullit 14 “Politikat e transportit”, kapitullit 15 “Energjia”, kapitulli 21 “Rrjetet transEvropiane” dhe kapitullit 10 “Transformimi digjital dhe media”, ka përfshirë edhe Hekurudhat Shqiptare, në veprim. Ligji 119/2024 për shtesa dhe ndryshime në ligjin 90/2021 për ndarjen e shoqërisë Hekurudha shqiptare është në zbatim me përcaktimin e kompetencave shtetërore për sipërmarrësin hekurudhor dhe përcaktimin e Ministrit përgjegjës për transportin, si pronar i aseteve të shoqërisë. Aktualisht, Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë ka publikuar thirrjen për dhënien të PSO-së.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka shpallur thirrjen për sektorin Hekurudhor shqiptar, prej datës 01.06.2026, sipas Shprehjes së Interesit për “Ofrimin e Shërbimeve të Transportit Publik Hekurudhor të Pasagjerëve në Shqipëri”, mbi shërbimet e transportit publik, të cilat do të përfshijnë furnizimin, operimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit të mjeteve hekurudhore, në sajë të inventarit të trenave të udhëtarëve, për të ofruar shërbime të tilla, gjatë një periudhe shumëvjeçare.

4. PLANET E RISKUT ME MASAT ANTIKORRUPSION

Veprimet e rinj kryesor, me fokus luftën kundër korrupsionit janë dhënë sa më poshtë vijon:

Nr	Risku	Para kontrollit	Kontrolli ekzistues	Pas kontrollit	Nevojat për kontroll të mëtejshëm	Zotëruesi I riskut	Ndryshimet në risk nga detyra e fundit	Tjetër
Objektivi 1. Përmirësimi i Etikës dhe Mekanizmave të Integritetit								
OS10 i Strategjisë së menaxhimit të riskut të HSH: Transparenca e Financave Publike në harmonizimin e objektivave tematik - Përmirësimi llogaridhënies menaxheriale institucionale								
1	Mospajtimi me kërkesat ligjore	2 (I ulët)	Mbrojtja e interesave financiare dhe rritja e sigurisë ndaj mashtrimit masat kundër korrupsionit aktiv/pasiv në fushën e menaxhimit financiar dhe kundër krimit fiskal dhe monetar	1 (I ulët)	Po	Drejtori ekonomik administrimi riskut +shefi financës si dhe shefja e kontabilitetit dhe grupet e komisioneve inventarizimit të ngritur me urdhër të administratores shoqërisë	Po përmirësohen < =	Publikimi i bazës ligjore për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, me sektorin TIK, MJ, koordinatoren e informimit me Publikun
Objektivi 2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse								
OS12: Bashkëpunimi i ngushtë mes njësisë, të menaxhimit financiar dhe ekonomik, të shërbimeve të prokurimit, administrimit, menaxhimit dhe kontrollit, si dhe të zbatimit të projekteve të akorduara, që detyrohen sipas ligjit, raportojnë periodikisht financimet dhe shpëndarjet e kapitalit, të aseteve dhe kostove								
2	Mospërditësi mes Planeve duke marrë për bazë mosbesimin tek stafi kyç	3 (i ulët)	Masat disiplinore/ ligjore anti-korrupsion dhe sinjalizohet sipas ligjit të sinjalizuesve kryhen bashkërendime me auditin e brendshëm AB si vëzhgues të statusit të përhershëm	2 (I ulët)	Po	Drejtori Ekonomik/ Administrimi i riskut në bashkëpunim me Drejtuesin e shërbimeve të brendshme, Kryesues i komisionit të etikës dhe integritetit	Po përmirësohen < =	Janë dorëzuar planet aktuale 2026, në bashkëpunim me sektorin juridik dhe BNJ, si dhe atë financiar/ Adm. Riskut

Objektivi 3. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes
OS13: Mbledhja e të ardhurave me transparencë në harmonizimin me objektivat tematik

3	Mosplotësi mi në afat i planeve të punës	3 (i ulët)	Monitorimi i treguesve, sipas Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsioni 2024–2030, planit të veprimt 2024–2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performance	2 (I ulët)	Po	Drejtuesi i njësisë	Ne permiresim	Plane të punës që janë lënë në detyrë, rishikuar klasteri 4 kap.14 & 21, dhe lufta kundër korrupsion
4	Moskoordinimi në shpezimet e fondit limit nga njësitë e biznesit	3 (i ulët)	Plani i punës për sektorin prokurime, dhe për sektorin juridik, afati i lënë është respektuar. Mund të hartohet strategjia e prokurimit të HSH, sipas strategjisë kombëtare të prokurimit ku është përfshirë sektori strategjik i transportit, llojet e tij.	2 (i ulët)	Po	GMR	Ka patur përmirësim	Pritet miratimi I Strategjisë së re të transportit (2026-2030)

Objektivi 4. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit financiar, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm

5	Mungesa e pajisjeve dixhitale	8 i lartë	Zbatimet për HSH, sipas Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 683, datë 6.11.2024 Për miratimin e metodologjisë “Për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit”, përfshire operacionet e transportit dhe infrastrukturën për hekurudhat.	7 (i lartë)	Po	GMR	Ne përmirësim	Po ndërtohet Qendra Kombëtare e Monitorimit të trafikut të trenave me projektin kryesor hekurudhor Durres-PTT-TIA dhe vendosjen e sistemeve Evropiane për monitorim trafikut, ERTMS
6	Mungesa e sistemit të informacionit në kohë reale për udhëtar	7 (I lartë)	Miratohet TSI TEL mbi sistemet telematike, dhe për ndryshimin, të Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 302, datë 27.11.2024 Për miratimin e rregullores “Kushtet teknike për ndërveprueshmërinë në lidhje me nënsistemin ‘Aplikacione telematike për shërbimet e udhëtarëve’ të sistemit hekurudhor”	6 (I lartë)	Po	GMR	Është përmirësuar	Është dorëzuar për miratim Projekt rregullorja e re TSI TEL nga Autoriteti I sigurisë hekurudhore për miratim të Ministrit

Objekti 5. Përmirësimi i drejtimeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në fushat e përgjegjësisë

7	Mungesa e moduleve shtesë të sistemeve të menaxhimit të integruar të BNJ	10 (i lartë)	Unifikimi i kërkesave tona për këtë sistem për trajnim të personelit merret në konsideratë me burimet njerezore dhe financat si përdorues të SIMBNJ për funksionet (15 funksione).	10 (i lartë)	Po	GMR	Pa ndryshim	AFMIS duhet të përmbajë funksionet e SIMBNJ me anë të shtesës së dy moduleve që janë vendosur në HSH.
---	--	--------------	--	--------------	----	-----	-------------	---

REGJISTRI I KËRKESAVE/ANKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Regjistri i Kërkesave, Ankesave dhe Përgjigjeve viti 2026						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	19.01.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me marrëdhënien juridike të "Hekurudha Shqiptare" sh.a, me godinën e ish repartit ushtarak (magazine) në Kurbin, ndodhur 5-6 metra nga vija hekurudhore (të dhënat personale të parashtruar në kërkesë janë trajtuar në zbatim të Ligjit nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale").	26.01.2026	U informua, referuar kërkesës së parashtruar.	E plotë.	Pa tarifë.

2.	19.01.2026	Kërkesë për informacion zyrtar mbi zhvillimin e projektit ekzistues të hekurudhës në rrugën “Jordan Misja” dhe përcaktimin e distancës ligjore të objekteve nga trupi hekurudhor, për qëllime legalizimi.	30.01.2026	U informua për sa parashtrorë në kërkesë. Sqarohet që kërkesa u kërkuar të saktësohet pas korespondencës së mbajtur me kërkuar. Objekti i kërkesës dhe përmbajtja e saj, u saktësua me date 23.01.2026.	E plotë.	Pa tarifë.
3.	30.01.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e zbatimit të projektit të rehabilitimit të hekurudhës “Durrës- Tiranë-Rinas” dhe komponentëve të tjerë plotësues.	05.02.2026	U informua, sipas pyetjeve të parashtruar dhe ju vendos në dispozicion për sa interesohej.	E plotë.	Pa tarifë.
4.	02.02.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e zbatimit të projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore “Durrës- Tiranë-Rinas”, komponentëve e tjerë plotësues dhe kostot respektive.	05.02.2026	U informua për sa kërkoj. Në pyetjen Nr. 7, dokumentacioni i kërkuar, gjen zbatim në Nenin 17, pika 1/b të Ligjit 119/ 2014 “Për të drejtën e Informimit” (i ndryshuar). Informacioni i dhënë mbështetet në dokumentacionit të cilit ju kufizua aksesit, sipas sqarimit të mësipërm	E plotë.	Pa tarifë.
5.	20.02.2026	Kërkesë për informacion	05.03.2026	U informua sipas pyetjeve që parashtrorë në kërkesë.	E plotë.	Pa tarifë.
6.	09.04.2026	Kërkesë për informacion	20.04.2026	U informua sipas pyetjeve që parashtrorë në kërkesë.	E plotë.	Pa tarifë.
7.	29.04.2026	Kërkesë për informacion	07.05.2026	U informua sipas pyetjeve që parashtrorë në kërkesë.	E plotë.	Pa tarifë.

III- ANALIZË SASIORE DHE CILËSORE E TË DHËNAVE TË RAPORTUARA

Sa i përket masave të parashikuara dhe të zbatuara, vlerësohet se janë ndjekur për cdo detyrë. I gjithë dokumentacioni dhe korrespondenca shkresore e Hekurudha Shqiptare sh.a. e cila administrohet (zhvillohet, regjistrohet dhe arkivohet), në përputhje me parashikimet e ligjit “Për Arkivat”, nr. 9154 date 06.11.2003, (ndryshuar me ligjin nr. 27/2024, datë 4.4.2024; nr. 99/2024, datë 12.9.2024), (i përditësuar) ka përcjellë aktivitetet, për të cilat monitorohemi, kundër cdo forme të korrupsionit. Procedura antikorrupsion është ngritur dhe monitorohet, përmes sistemit të sinjalizimit, sipas ligjit për sinjalizimin. Krijimi i komisionit për etikën në punë të HSH-së, i cili ngrihet me Urdhër të Administratorit, merr në shqyrtim cdo ankesë sipas mekanizimit të trajtimit të ankesave sipas programit të përputhshmërisë. Për këtë HSH ka shpallur edhe Raporte të auditit të jashtëm, të cilat japin gjetjet me të dhënat dhe rekomandimet, sipas KLSH: https://hekurudha.al/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI_2023.pdf, me masat në 2025-2026.

Drejtoria DSHBM, HSH, me drejtuesen, përgjegjësit e sektorëve dhe trajtimit të ankesave kryen raportimin periodik ndaj MIE, dhe MF, mbi: Regjistrin e kërkesave (ankesave) dhe përgjigjeve, i cili u koordinua me Drejtuesen DSHBM, dhe Koordinatorin e informimit publik, sipas sistemit: <https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/>, të shpallur në faqen zyrtare: <https://hekurudha.al/programi-i-transparences-3/#here>. Programi i trajnimit me masat kundër çdo forme të diskriminimit dhe të korrupsionit, i përgatitur tashmë, ndiqet me përpikmëri, duke bërë që, punonjësit të trajnohen dhe ngrenë njohuritë, për të cilat përgatiten përmes punës.

Në një ndër aspektet të zbatimit të Ligjit Nr. 142/2016 Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë, Neni 155, mbi Parimet e hartimit të kontratës me interes ekonomik të përgjithshëm, parag. 4, përcakton mbi organizimin e një udhëheqjeje dinamike dhe sigurimin e drejtimit të përgjegjshëm:

- a) ndihmesa e sipërmarrjes në drejtimin e sistemit hekurudhor;
- b) drejtimi, organizimi i sipërmarrjes dhe strategjia e kompetencës.

Gjatë vitit 2025 dhe në vitin 2026, në masat e percaktuara, u mor pjesë në trajnimin mbi rrjetin e gruas në transport, (WiT), me donatorët e Grupit të Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane të Investimeve (EIB), me stukturat drejtuese të DBSHM dhe supervizimit të burimeve njerëzore qëndrore, si dhe marrëdhënieve me jashtë dhe menaxhimit të ankesave, të Hekurudhës Shqiptare. Plan i aktiviteteve dhe treguesit e rezultateve, përfshijnë shtyllat kryesore me masat strukturore:

- Shtylla (1) Tërheqja e talenteve për transportin hekurudhor, dhe rekrutimi;
- Shtylla (2) Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikrat që ndiqen për to;
- Shtylla (3) Progresi i udhëheqjes (Leadership-it) dhe Avancimi i karrierës;
- Shtylla (4) Korniza e Politikave të fushës, si dhe Kufizimet rregullatore;

Shtylla (5) Kërkimi dhe zhvillimi në eficensën e burimeve njerëzore, duke përfshirë edhe barazinë gjinore për sektorin e transportit hekurudhor, i cili u mbajt në 30/01/2025 dhe online 3 takime 2026.

Në muajin Mars 2025, HSH ka marrë pjesë në trajnimin e transportit të mallrave të rrezikshme me ane të projektit të asistencës së BE, TAIEEX, mbi zbatimin dhe adaptimin e Kodit IMDG dhe rregulloreve ndërkombëtare me rrugë dhe hekurudhë RID, në Hamburg dhe Bremen e Bremerhaven. Në Gjermani, në muajin Mars, 2025, trajnimi ku mori pjesë HSH, ka përfshirë, në radhë të parë, strategjitë e mbrojtjes së kufijve nga çdo lloj trafiku i paligjshëm, i cili mund të përfshijë edhe lëndët e rrezikshme, sipas ligjit në fuqi. Në muajin Maj 2025, Hekurudha kryesoi takimin e trajnimit të TAIEEX mbi mallrat e rrezikshme, i cili u organizua në Kotor të Malit të Malit të zi, me strukturat e MIE, dhe TCT, dhe organet e varësisë për zbatimin e ligjit 118/2012 mbi transportin e mallrave të rrezikshme. HSH e cila ka kryesuar trajnimin dhe Drejtoria e përgjithshme e doganave me strukturën Antikorrupsion, kanë marrë rekomandimet e vlefshme nga OTIF dhe UNECE, UN. Në Qershor 2025, HSH mori pjesë me MIE dhe organet e përfshira në sistem, me doganat shqiptare, të cilat kanë sistemet e monitorimit dhe kontrollit kundër korrupsionit, përmes komitetit Teknik të lehtësimit të transportit dhe tregëtisë së TCT, me MIE-në, dhe APD, etj, në trajnimin workshop të strukturave të sekretariatit të transportit TCT, në Ohër të Maqedonisë së Veriut, mbi implementimin e Sistemit TODIS, databazës së observatorit të komunitetit transportit.

Punonjësit e HSH, kanë marrë trajnim në 3 M III, të vitit 2025, mbi arshivat dhe proceset me të cilat ruhet dokumentacioni. Projekti Asistenca teknike për PIU të Hekurudhës shqiptare (njësitë e zbatimit të projekteve) i miratuar brenda PBA 2025-2027 dhe 2026-2028, si dhe PBA i ri, për 2027-2029, sipas vendimeve të QSH-së, është ndjekur nga sektori i burimeve njerëzore me përpikmëri, duke angazhuar përmes DSHBM dhe NJZMP, të gjitha strukturat e punës për t'u trajnuar dhe ngritur kapacitetet njerëzore të hekurudhës shqiptare, me një database për të gjithë trajnimet dhe certifikimet të personelit për institutionin Hekurudha shqiptare.

Mekanizmi i ankesave është ngritur dhe funksionon në: <https://hekurudha.al/baza-ligjore/#gothere>. Sipas rregullores, Kreu II, Ngritja dhe Funksionimi i Strukturave Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike të HSH, Neni 8 Autoritetet përgjegjëse. 1. Autoritete përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, janë percaktuar, sipas hierarkisë dhe kësaj rregulloreje. Ato janë angazhuar plotësisht në marrjen dhe trajtimin e ankesave, për zgjidhjen e tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave antikorrupsion;

- (a) Administratori i Shoqërisë; (b) Asistenca Administratorit; (c) Sektori i Auditimit të Brëndshëm;
- (ç) Drejtoria Shërbimeve të Brendshme Mbështetës; (d) Drejtoria Ekonomike/Administrim Risku;
- (dh) Njësia e Biznesit të Udhëtareve; (e) Njësia e Biznesit të Mallit; (ë) Njësia Mjeteve Lëvizëse.
- (f) Drejtoria e zbatimit e menaxhimit të projekteve; dhe (g) Njësia e Infrastrukturës Hekurudhore.

Masa merren kur provohet, se është prekur integriteti dhe parimet të kodit të etikës dhe integritetit dhe të tjera masa të detyrueshme, të cilat mund të merren dhe ndiqet me rigorozitet nga Komisioni i Etikës dhe disiplinës në punë, i cili ngrihet çdo herë, në mirëfunksionimin e Hekurudha shqiptare. Procesi vlerësues i performancës së personelit dhe drejtuesve të ekipeve, për shkak të shkeljeve të kodit të etikës dhe / ose rregullores së parandalimit të konfliktit të interesit të HSH, është aktual dhe ndiqet në të gjithë nivelet duke nisur me Administrimin e shoqërisë, Administratorin HSH, si nëpunës autorizues, nepunesit zbatues I-III, drejtuesit e varësisë, si anëtarët të grupit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut të HSH, çdo menaxhues i njësive shpenzuese të HSH, në përbërje të GMS, GMR dhe GMSR së çdo njësie shpenzuese, sipas legjislacionit të koordinimit të të gjitha risqeve, dhe secili supervisor i sektorit përkatës (përgjegjës sektori, drejtuesi i Drejtorisë ose njësisë së vet).

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin dhe Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Hekurudhën Shqiptare sh.a. Durrës, e cila hartohet dhe miratohet në bazë të nenit 46 paragrafi 1 i ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”. Në këtë aspekt, të raportimit, përmbledhim mbledhjet e komisionit të etikës dhe disiplinës në punë, si: Takim i komisionit DT. 28.01.2025, për shkelje të etikës dhe marrja e vendimit "verejtje me paralajmerim"; takimi i komisionit të etikës DT. 18.09.2025 dhe marrja e vendimit për dhënie "ulje ne detyre"; komisioni u rimblodh dhe mori vendimin "Pushim nga puna" dhe ne vijim ne V. 2026. Kjo rregullore e cila zbatohet, monitorohet dhe raportohet ne HSH, bazohet në ligjin e mësipërm si dhe në ligjin nr. 9049 datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, për të përshtatur kuadrin ligjor, duke theksuar rëndësinë e kontrollit të integritetit të funksionarëve publikë, me Ligj 105.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare" dhe të “Rregullores së Organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë HSH”, te ndryshuar.

Titullari (Këshilli mbikëqyrës) dhe NA (Nëpunësi autorizues / Administratori i shoqërisë), mbikëqyr ndër të tjerë, krijimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke përfshirë masat antikorrupsion të HSH-së, përmes urdhërave administrative dhe institucional:

1. Manual Udhëzues për administrimin e aseteve në HSH, nr. 10, datë 18.01.2024 "Rregullore "Mbi menaxhimin e aktiveve dhe vlerave të shoqërisë Hekurudha shqiptare SH.A.", Nr. 63 prot, datë 18.01.2024; dhe zbatim përmes Urdhërit nr. 5/2026 mbi ngritjen të GMS-së;
2. Zbatim për Urdhër 6/2026 " Për ngritjen e grupit të Menaxhimit të riskut (GMR) dhe detyrimet për raportimin e HSH-së" sipas miratimit të Grupit të menaxhimit të riskut HSH;
3. Vendimet e Komitetit drejtues të vendimmarrjes strategjike dhe grupit të menaxhimit të riskut, në përputhje të veprimeve përcaktuar nga "Strategjia e menaxhimit te riskut (HSH) dhe Planit afatgjatë të veprimit (2025)", të cilat i propozohen më tej, këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, si organi drejtues i nivelit të lartë për shoqërinë Hekurudha Shqiptare (HSH).

Raportet të marra nga 8 strukturat e HSH të Këshillit Mbikëqyrës të dërguara nga administrimi për tek njësitë shpenzuese HSH, përmbledhin një paketë të plotë dokumentare me cilësi dhe integritet:

1. Projekt programin e zhvillimit ekonomik viti 2025 dhe parashikimi 2026-2027, data 20.01.2025; 2. Projekt struktura e Shoqerise, data 20.01.2025; 3. Plani strategjik 2025-2027 dhe Plani vjetor 2025 për Auditin e brendshëm, datë 20.1.2025; 4. Karta e Auditimit të Brendshëm, data 20.01.2025; 5. Nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve të ndryshme hekurudhor, të NJBMIH, data 20.01.2025; 6. Nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve të ndryshme vagonë malli tip VS/P, data 20.01.2025; 7. Rizgjedhje në detyrë të Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, Hekurudha Shqiptare, data 20.01.2025; 8. Raporti vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, data 22.07.2025; 9. Programi Vlerësimit të brëndshëm të Cilësisë së Auditimit të Brëndshëm, data 22.07.2025; dhe 10. Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2024, HSH, si dhe raportin e auditimit ligjor, data 22.07.2025.

Në sistemin e mbikëqyrjes së performancës operationale HSH, financiare dhe jo-financiare, me masat kundër korrupsionit aktiv dhe pasiv, ai është i bazuar në objektivat e PBA dhe treguesit të performancës, të miratuar në Vendim i Këshillit të Ministrave, për miratimin e PBA 2027-2029, të miratuar më 30.06.2026. HSH, po zbaton qëllimin e politikës së programit, për hekurudhat me:

Integrimin e sistemit hekurudhor shqiptar me atë rajonal dhe Evropian në nivel administrativ dhe funksional. Raporti i investimeve përmban sipas programit: Studime dhe projekte; FS të fizibilitetit të Projekteve; Makineri dhe paisje për mirëmbajtjen e linjës; Mirëmbajtje dhe riparime për makineri; Blerje pjesë këmbimi për lokomotiva dhe vagonë; Projekti Durrës- Rrogozhinë; Projekti i Elektrifikimit të linjës; Zbatimi i Projektit inxhinierik dhe arkitekturor; Supervizioni i punimeve "Rehabilitimi i linjës hekurudhore"; Asistencë Teknike për Suportin e PIU për projektin hekurudhor; TVSH për zbatimin e projektit Rehabilitimit Vora-Hani i Hotit; TVSH për supervizionin e punimeve "Rehabilitimi i linjës Vora-Hani I Hotit"; TVSh për zbatimin e ndërtimin e godinave të stacioneve; TVSH për "Hartimin e projektit të Elektrifikimit të linjës"; TVSH për "Hartimin e projektit të detajuar"; Zbatimi i projektit të rehabilitimit të linjës Tiranë-Durrës- Rinas.

Të gjithë monitorimet dhe situacionet së bashku me kalendarët me afat dhe kushtet, janë raportuar në mbledhjen e GMR HSH të 13/02/2026, sipas urdhërit të administratorit të Hekurudha Shqiptare. Hekurudha Shqiptare vijon programin e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të infrastrukturës hekurudhore, të promovuar fuqimisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë.

Përmes projekteve hekurudhore për elektrifikimin e linjës hekurudhore Durrës-Terminali i Transportit publik të Tiranës dhe lidhja me Aeroportin ndërkombëtar të Tiranë, me Rinas, dhe rehabilitimit të linjës hekurudhore Vora-Hani i Hotit kufiri me Malin e Zi, si dhe Durrës-Rrogozhinë, po zhvillohet sipas programit të miratuar, Projekti i zgjatimit të linjës hekurudhore Terminali i transportit publik të Tiranës për në bulevardin e ri të Tiranës, 4.6 km, i cili është në prokurim të hapur, për ndërtimin, me punime civile, mallra dhe shërbime.

5. TË DHËNAT DHE RUAJTJA E TYRE

Nga raporti i kontrollit të brendshëm, i cili përfshin masat antikorupsion, të miratuar nga Titullari i Institucionit (Këshilli Mbikëqyrës), raportimi i të dhënave u pasqyrua me programin e zhvillimit ekonomik viti 2025, parashikimi viti 2026-2027; Plani strategjik 2025-2027 dhe plani vjetor 2025 i Auditit; Raporti vjetor të Auditimit të Brëndshëm dhe Programi Vlerësimit të brëndshëm të Cilësisë së Auditimit të Brëndshëm; PF - Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor, si dhe raportin e auditimit ligjor, në datën 22.07.2025. Janë dhënë me të gjitha gjetjet dhe rekomandimet po ashtu, me analizën dhe adresimit të çështjeve të nevojave, nga Audit (AB) dhe Administratori i shoqërisë. Në HSH, masat janë miratuar dhe ndiqen, sipas urdhërit administrativ të GMS, me mbledhjet javore, periodike mujore të nivelit menaxherial (drejtuesit e drejtorive dhe njësive, si anëtarët e grupit të menaxhimit të risqeve të shoqërisë), me Administratorin HSH dhe grupin të menaxhimit të risqeve GMR, dhe vendim-marrjet nga Titullari i shoqërisë (këshilli mbikëqyrës), së paku një herë në cdo 3 muaj. Për këtë administratori ka nënshkruar protokollet e tyre dhe i janë dërguar cdo njësie dhe drejtorie, sipas dakordësimit me nënshkrimin përkatës të cdo anëtari {1 kryetari, i nënshkruar, 12 anëtarë duke nënshkruar, dhe 1 drejtuesi i SAB (AB)}, nënshkruar pa të drejtë vote.

Titullari (Këshilli Mbikëqyrës) dhe Administratori i shoqërisë (i cili i miraton, duke qene se nuk është anëtar i këshillit mbikëqyrës), dhe ka autorizimin e asamblesë së përgjithshme, merr opinion mbi performancën e institucionit duke u fokusuar mbi masat antikorupsion, sipas programit të përputhshmërisë (KLSH), programit transparent të monitorimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), dhe Ministria e Financave (MF), si dhe Njësia e Auditit të brëndshëm (SAB), njëkohësisht merr opinion në cdo projekt të shqyrtimit të veprimtarisë dhe performancës së Hekurudhës shqiptare. Janë dorëzuar, raportet e audituesve të ekspertëve të jashtëm, të cilët kanë kryer ekspertizën e performancës dhe të reformës së ndarjes së shoqërisë, si dhe ndaj donatorëve ndërkombëtarë, të cilët bashkëfinancojnë kompaninë HSH, përmes programit buxhetor afatmesëm, dokumentit prioritar të politikave me anë prioriteteve dhe të projekteve dhe programit të reformës ekonomike, të masës së rehabilitimit të hekurudhave shqiptare, sipas paketës unike të projekteve të zhvillimit të hekurudhave shqiptare me grantet dhe kredi të huaja. Po kështu edhe komisioni i dhënies së ndihmës shtetërore, i cili merr raportin e performancës dhe jep opinion dhe autorizon dhënien e ndihmës subvencion vjetor, për shoqërinë Hekurudha shqiptare HSH Sha, periodikisht.

6. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Monitorimi dhe raportimi realizohen përmes strukturave drejtuese dhe menaxheriale, me përfshirjen e Këshillit Mbikëqyrës, Administratorit dhe Njesisë së Auditimit të Brëndshëm. Në nivelin e zbatimit të ligjit dhe strategjisë antikorupsion, raportohet tek Këshilli Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga 4 (katër) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, ku kohëzgjatja e funksionit të tyre është 3 (tre) vjet dhe bazuar në Statutin e shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës zgjedhi ndërmjet anëtarëve të tij 1 (një) Kryetar dhe 1 (një) Zëvendës Kryetar.

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në bazë të legjislacionit të fushës së menaxhimit dhe masave antikorrupsion, vlerësohet se masat antikorrupsion janë marrë në kohë dhe kontrollohen vijimisht, në përputhje me Kodin Hekurudhor Shqiptar. Vijon procesi i përmirësimit të sistemeve financiare dhe dixhitale (p.sh. “Financa 5”, AFMIS), si dhe nevoja për zhvillimin e sistemeve elektronike të llogaritjes së kostove dhe monitorimit operacional. Vijon monitorimi dhe raportimi i tyre, sipas procesit strategjik, i cili prek sektorin e transportit dhe sektorë të tjerë, të rëndësishë kombëtare dhe të rëndësishë së vecantë, ekonomike, dhe atë kritike. Në Autoritetin Licensues Hekurudhor, u bë ndryshimi i pronarit të shoqërisë aksionere HSH. Do pritet që të jetë finalizuar ndarja e menaxhimit nga operacionet. Për këtë mund të mbështetemi në ekstraktin e QKB-së, si autoriteti licensues hekurudhor, i cili ka përcaktuar edhe emrat e anëtarëve, profesionstëve më të mirë të fushave në KM Mbikqyrës. <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/> Nipti: J61811547D Emri i Subjektit: Hekurudha Shqiptare, Objekti i Aktivitetit: Transport Mallrash, Udhëtarësh, Ngarkim, Shkarkim. Në objektin e veprimtarisë me regjistrimin e shoqërisë pritëse, do përfshijë menaxhimin e infrastrukturës, dhe menaxhim projektësh, si dhe licensimi si qendër e formimit profesional, sipas ligjit mbi AFP/QFP, me shoqëritë tregtare. Ligji Nr. 15/2017 Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Shqipëri, Neni 12, përcakton Ofruesit e AFP-së, pika 1. AFP-ja ofrohet ndër të tjera, nga: d) shoqëritë tregtare; dh) institucionet e tjera të licencuara dhe/ose të akredituara ose individët.

- Mbrojtja e interesave financiare dhe rritja e sigurisë ndaj mashtrimit masat kundër korrupsionit aktiv/pasiv në fushën e menaxhimit financiar, kundër krimit fiskal e monetar
- Masat disiplinore/ ligjore anti-korrupsion dhe sinjalizohet sipas ligjit të sinjalizuesve kryhen bashkërendime me auditin e brendëshëm AB si vëzhgues të statusit të përhershëm
- Monitorimi i treguesve, sipas Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsioni 2024–2030, planit të veprimit 2024–2026 dhe pasaportës së treguesve të performances me luftën kundër korrupsionit
- Plani i punës për sektorin prokurim publik dhe sektorin juridik, afati i lënë është respektuar.
- Pritet miratimi i strategjise sektoriale të transportit, dhe po zbatohet regjistri i prokurimit.
- Zbatimet permes Vendimit KM-së, nr. 683, datë 6.11.2024 Për miratimin e metodologjisë “Për identifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit”, duke përfshirë operacionet e transportit dhe infrastrukturën për hekurudhat.
- Pritet miratimi i kushteve për ndërveprim hekurudhor TSI TEL, me ndryshimin e sistemeve telematike, sipas Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 302, datë 27.11.2024 Për miratimin e rregullores “Kushtet teknike për ndërveprueshmërinë në lidhje me nënsistemin ‘Aplikacione telematike për shërbimet e udhëtarëve’ të sistemit hekurudhor”.
- Unifikimi i kërkesave HSH, për këtë sistem për trajnimin e personelit merret në konsideratë me burimet njerezore dhe financat si përdorues të SIMBNJ për funksionet (15 funksione).

7. KONKLUZIONE

Në bazë të legjislacionit të fushës së menaxhimit dhe masave antikorruption, vlerësohet se masat antikorruption janë marrë në kohë dhe kontrollohen rigorozisht, në përputhje me Kodin Hekurudhor të Republikës së Shqipërisë. Vijon procesi i përmirësimit të sistemeve financiare dhe dixhitale, si dhe nevoja për zhvillimin e sistemeve elektronike të llogaritjes së kostove dhe monitorimit operacional. Në veprimtarinë të transportit hekurudhor vlerësohet se, masat antikorruption janë zbatuar në afat, sipas Planit dhe sipas nenit 159, kundërvajtjet administrative, të cilat nëse nuk përbëjnë vepër penale, për veprimet dhe mosveprimet, ndërmerren në përputhje me Ligjin Nr. 142/2016 Kodi Hekurudhor Shqiptar, Ligjit nr. 88/2021, datë 1.7.2021 Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore, Ligjit nr. 89/2021, datë 1.7.2021 Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor. Udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 24, datë 13.12.2022 Për formimin profesional në qendrat e formimit profesional të personelit hekurudhor, që ushtron funksione sigurie, kushtet dhe procedurat për testimin, licencimin dhe certifikimin e makinistëve, përmban masat kundër mashtrimit, dhe sipas Korrigjim gabimi material në udhëzimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 24, datë 13.12.2022, “Për formimin profesional në qendrat e formimit profesional të personelit hekurudhor, që ushtron funksione sigurie, kushtet dhe procedurat për testimin, licencimin dhe certifikimin e makinistëve”, botuar në Fletoren zyrtare nr. 174, datë 23.12.2022, si në botimin në Fletoren Zyrtare Nr. 3, datë 9 Janar 2023.

HSH ka marrë trajnim IPA, me ERA, mbi auditimin (2026) dhe investigimin (2026), duke respektuar, vlerësimin e rreziqeve, sipas Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 52, datë 17.3.2022 Për miratimin e rregullores “Për metodologjinë, rregullat, procedurat, standardet dhe praktikat për kryerjen e investigimit të aksidenteve dhe të incidenteve hekurudhore dhe detare”. Për këtë qëllim, hekurudha shqiptare, e cila është përdorues i autorizuar i databazës së monitorimit të performancës së rrjeteve Trans-Evropiane, TEN-T, me TODIS, në TCT, ka përditësuar në 15.07.2026, të gjithë treguesit kyc të performancës së rrjetit hekurudhor dhe të dhënat të projekteve.

Plani i Integritetit, në Hekurudha shqiptare, përmbledh zbatimet hekurudhore, si subjekt i zbatimit të ligjit të ndarjes Ligj 90/2021 si dhe shtesave dhe ndryshimeve që mori, prej muajit dhjetor 2024, me Ligjin nr. 119/2024, datë 12.12.2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 90/2021, “Për ndarjen e shoqërisë ‘Hekurudha shqiptare’ sh.a. Aktualisht jemi në auditim, në vendosjen e sistemit financiar “Financa 5”, funksional vetëm në drejtorinë ekonomike dhe administrimin e riskut, kryesisht për investimet dhe projektet hekurudhore, llogaritë e thesarit, sipas sistemit të integruar AFMIS, të 2 moduleve të tij, pjesore. Sistemi elektronik i përllogaritjes së orëve të qëndrimit të trenave është i nevojshëm, pasi mungon dhe sistemi elektronik i llogaritjes së kostove direkte, sipas Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 250, datë 25.10.2024 Për miratimin e rregullores “Për modalitetet e llogaritjes së kostos që shkaktohet drejtpërdrejt si rezultat i funksionimit të trenave dhe aplikimit të tarifimit për koston e efekteve të zhurmës”, në zbatim.

8. REKOMANDIME

Rekomandohet vijimi i masave për përmirësimin e kuadrit të MFK-së, përditësimi i rregulloreve të brendshme dhe forcimi i kapaciteteve institucionale, në përputhje me aktet nënligjore dhe udhëzimet e miratuara.

- Udhëzimi i MF-së nr. 2, datë 26.01.2024, mbi deklaratën/raportin vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm (Anekset 1–5);
- Urdhri i MF-së nr. 4, datë 26.01.2024, për miratimin e manualit të MFK-së;
- Udhëzimi i MF nr. 16, datë 31.12.2024, mbi koordinimin e MFK dhe funksionimin e GMR;
- Udhëzimi DAP nr. 02, datë 21.01.2025, mbi rolin e BNJ për etikën në AP;
- VKM nr. 83, datë 05.02.2025, Kuadri Makroekonomik Fiskal 2026–2028;
- Vendimi nr. 180, datë 20.03.2025, Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 887/2022 “Për Procedurat Menaxhimit të Investimeve Publike”, të ndryshuar
- Udhëzimi i MF nr. 11, datë 28.05.2025, mbi kufirin financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit mbi bazë të të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik;
- Vendimi për miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2027–2029;
- Urdhër i MIE nr. 141, datë 02.10.2025 Për ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e planit.
- Urdhër i MF nr. 49/1, datë 21.10.2025, "Për miratimin i metodologjisë për vlerësimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njërive të qeverisjes së përgjithshme"
- VKM nr. 743, datë 12.12.2025, Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2026–2030;
- Udhëzimi i MF nr. 127, datë 19.12.2025, procedurat e mbylljes së llogarive vjetore 2025;
- Ligji nr. 1/2025, datë 30.1.2025 Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës”, ligji nr. 29/2017;
- Urdhër Nr. 164, Datë 21.10.2025 Për Miratimin e Rregullores “Mbi Aspekte të Caktuara të Kushteve të Punës së Punonjësve të Lëvizshëm të Angazhuar në Shërbime Ndërvepruese Ndërkufitare në Sektorin Hekurudhor”

HSH merr masa të reja kundër korrupsionit, të cilat lidhen me veprimet, dhe hapat mbi zbatueshmërinë e legjislacionit të miratuar së fundmi. Afati i dorezimit të raportit mbi kostot direkte, është përcaktuar, brenda 1 Korrik 2027. Për kontrollin e thjeshtëzuar të kostove, vepron Autoriteti Rregullator hekurudhor, me kërkesë.

V- SHTOJCAT

Shtojca 1 – Regjistri i riskut

Shtojca 2 – Plani i zbutjes së riskut

Shtojca 3 – Dokumentacion mbështetës (sipas nevojës), me deklaratën e rrjetit hekurudhor HSH.

Lista e dokumentave që administrohen me afatet e ruajtjes <https://hekurudha.al/baza-ligjore/>

Lista me afate e ruajtjes së dokumentave që administrohen nga “Hekurudha Shqiptare” sh.a
<https://hekurudha.al/wp-content/uploads/2026/02/Lista-konkrete-me-afatet-e-ruajtjes-se-dokumentave-te-Shoqerise-Hekurudh.pdf>

Ligji për “Arkivat” Nr.9154 06/11/2003 (i ndryshuar)

<https://hekurudha.al/wp-content/uploads/2026/02/Ligj-per-Arkivat.pdf>

Vendimi Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e ‘Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë’

<https://hekurudha.al/wp-content/uploads/2026/02/vendim-2017-06-19-4.pdf>

Formë e dokumentave/informacioneve (elektronik, kopje fizike)

<https://hekurudha.al/wp-content/uploads/2026/02/Formen-e-dokumentave-informacioneve-elektronik-kopje-fizike-audio-video-.pdf>

RREGJISTRI I KËRKESAVE/ANKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

<https://hekurudha.al/programi-i-transparences-3/>

Administrimi Dokumentacionit

<https://hekurudha.al/wp-content/uploads/2022/08/Administrimi-Dokumentacionit-1.pdf>

Shtojca 1.Hartat e rrjetit TransEurop.Ballk.Perend.

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-1-hartat-e-rrjetit-transeurop-ballk-perend/>

Shtojca 2. Kushtet e pergjith.Perdorim. Infrastrukt.

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-2-kushtet-e-pergjith-perdorim-infrastrukt/>

Shtojca_3 INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_3-infrastruktura-hekurudhore/

Shtojca_3_1_a_Te dhena teknike mbi vijen hekurudhore

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_3_1_a_te-dhena-teknike-mbi-vijen-hekurudhore/

Shtojca_3_1_b. Te dhena teknike mbi stacionet hek

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_3_1_b-te-dhena-teknike-mbi-stacionet-hek/

Shtojca_3_2_Harta,paisje,instalime e vijes hekurudhore

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_3_2_hartapaisjeinstalime-e-vijes-hekurudhore/

Shtojca_3_3Planet skemat. e stacion. hekurudh.

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_3_3planet-skemat-e-stacion-hekurudh/

Shtojca_3_4_Hapsira e lire, permasat e ngark.

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_3_4_hapsira-e-lire-permasat-e-ngark/

Shtojca 3-5,Pjerresite vijes, rezistenca .

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-3-5pjerresite-vijes-rezistenca/>

Shtojca 3.6 Shpejtesite e lejuara te vijes

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-3-6-shpejtesite-e-lejuara-te-vijes/>

Shtojca 3-7 Lista e stacioneve per dergesat

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-3-7-lista-e-stacioneve-per-dergesat/>

Shtojca _3_8_Kapaciteti i terminalit portit

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-3_8_kapaciteti-i-terminalit-portit/

Shtojca_4. Shperndarja e itinerareve

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_4-shperndarja-e-itinerareve/

Shtojca 4.1. Forma e kërkeses se aplikimit

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-4-1-forma-e-kerkeses-se-aplikimit/>

Shtojca_4_2_ Shperndarja ,metoda vleresimit.,

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_4_2_shperndarja-metoda-vleresimit/

Shtojca 4-3 lista e itenerareve te caktuar

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-4-3-lista-e-itenerareve-te-caktuar/>

Shtojca 4-4 Orari i Trenave ne Vijen Kufitare Bajze-Tuz.

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-4-4-orari-i-trenave-ne-vijen-kufitare-bajze-tuz/>

Shtojca_5. Sherbimet ne objekte dhe impiante sherbimi

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_5-sherbimet-ne-objekte-dhe-impiente-sherbimi/

Shtojca_5_1. Rruga e hyrjes ne objektet e sherb. Mjeteve

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_5_1-rruga-e-hyrjes-ne-objektet-e-sherb-mjeteve/

Shtojca 5.2. Lista e stacioneve. hekur. udhet.

<https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca-5-2-lista-e-stacioneve-hekur-udhet/>

Shtojca_5_3_ Lista stacioneve manovrimit

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_5_3_lista-stacioneve-manovrimit/

Shtojca_5_4_ Lista stacioneve proc. teknologji.

https://hekurudha.al/administrimi-dokumentacionit/shtojca_5_4_lista-stacioneve-proc-teknologji/